



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 11520 Prot

Lezhë, më 24.06.2025

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Për dijeni: Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53 pika 2, pika 4, neni 56, pika 2 shkronja “a” dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.prot. 358/1, datë 15.05.2020, i ndryshuar, njoftoj thirrjen e **mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e hënë, në datën 30.06.2025, në orën 12:00, në sallën e Këshillit Bashkiak (në Pallatin e Kulturës Lezhë), me këtë**

REND DITE:

1. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Maj 2025”
2. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. D.D. për djegie banese”
3. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. J.G. për djegie banese”
4. Projekt-Vendim “Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK”
5. Projekt-Vendim “Për miratimin e buxhetit faktik për 4-mujorin e parë të vitit 2025”
6. Projekt-Vendim “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 të Bashkisë Lezhë (Faza e Parë)”
7. Projekt-Vendim “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore”
8. Projekt-Vendim “Për miratimin e hapjes së rrugës së lagjes Butem dhe dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar, shoqërisë T&J Construction shpk për ndërtimin e rrugës auto të lagjes Butem, fshati Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë”
9. Projekt-Vendim “Për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë, Shqipëri dhe Komunës San Demetro Corone, Itali”
10. Informacion nga Bashkia Lezhë mbi zbatimin e buxhetit për 5-mujorin e vitit 2025
11. Informacion nga Bashkia Lezhë për masat e marra për sezonin turistik 2025
12. Të ndryshme

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve:

Nr	Komisioni	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Strehimit	E premte	27.06.2025	09:00

2	Komisioni i Sigurisë Publike dhe Emergjencave Civile	E premte	27.06.2025	09:15
3	Komisioni i Mandateve, Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike	E premte	27.06.2025	09:30
4	Komisioni i Bujqësisë	E premte	27.06.2025	09:45
5	Komisioni i Urbanistikës, Programeve të Zhvillimit dhe Integritit	E premte	27.06.2025	10:00
6	Komisioni i Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik	E premte	27.06.2025	10:15

**KRYETARI
NDUE LULI**

